VENDIM
Nr. 226, datë 9.11.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "ALBESP TRADING & CONSULTING" SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "d"; nenit 5, pika 1, germa "d" dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 139/5 prot., datë 2.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë 'AlbEsp Trading & Consulting' sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1021 prot., datë 26.10.2021, ka paraqitur aplikimin për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për shoqërinë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: "a", "b" dhe "c", plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "e", plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa "c" dhe "d", plotësuar;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7, germat "a", "b" dhe "c", plotësuar.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa "c" (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB-ja), plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentin e plotë në formën e kërkuar nga rregullorja (jo vetëm faqen e parë të dokumentit);

- germa "d" (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë edhe për administratorin e shoqërisë dhe vërtetimet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për shoqërinë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k., si dhe për administratorin e saj;

dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa "a" (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore), plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore.

Në vijim të letrës mbështetëse të lëshuar nga "Credins Bank" me nr. 506 prot., datë 25.10.2021, shoqëria duhet të bëjë me dije ERE-n nëse i ka plotësuar kriteret financiare të

vendosura nga banka, në kuadër të mbështetjes financiare që kjo e fundit do t'i mundësojë për ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën kërkon të licencohet;

dokumentacionin teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7:

- germa "e" (sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi), plotësuar pjesërisht. Duke qenë se shoqëria është në proces për krijimin e sistemit IT, vlerësojmë që në rast miratimi të licencimit të saj, t'i lihet si kusht depozitimi në ERE i sistemit IT, pas krijimit;

- germa "g" (dokumentacioni që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve), plotësuar pjesërisht. Në vijim të deklaratës së shoqërisë se nuk mund të krijohen zyrat përfaqësuese në këtë moment, pasi nevojitet shpërndarja gjeografike e klientëve, vlerësojmë që në rast miratimi të licencimit të saj, t'i lihet si kusht depozitimi në ERE i dokumentacionit që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve, pas krijimit të tyre;

- germa "i" (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët), plotësuar pjesërisht. Në vijim do t'i kërkohet shoqërisë të bëjë me dije nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët të cilët do të furnizojë, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti